37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

KB

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do

V.B

të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43                      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a)            ose vendim nga gjyqi;
- b)            kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

K.B



### PJESA III E KONTRATES

### Kushtet E Veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-------------------------------------------|-----------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|                                           | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Personeli                                 | 9         | <p>Personeli kyç i identifikuar në kete projekt nga OE për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Menaxher i Projektit – Zijadin Mehmeti, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë</li> <li>2. Udhëheqës i punishtës – Sami Lokaj, inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë</li> <li>3. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë – Florent Emini, inxhinier i diplomuar i gjeodezisë</li> <li>4. Inxhinier i komunikacionit – Sejdi Muharremi, inxhinier i diplomuar i komunikacionit</li> <li>5. Inxhinier i elektroteknikës – Hebib Dernjani , inxhinier i diplomuar i elektroteknikës</li> <li>6. Inxhinier i Hidroteknikës – Gzim Demelezi, inxhinier i diplomuar i hidroteknikës</li> </ol> <p>Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.</p> |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është 784,971.62 euro deri me date 29.07.2022                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | <p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>Sigurimi i vend punishtës do të jetë përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve në vend punishtë janë në përgjegjësi të Operatorit ekonomik deri në shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtës do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtës pra + 30 dite.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Programi                                  | 12.1      | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                           | 12.2      | Periodha për Programin e azhurnuar është 20 ditë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |

|                        |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|------------------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Fillimi i punëve       | 17.1 | Data e fillimit do të jetë 22.09.2020 (per shkak te dantimit te rrugës dhe situatës emergjente te krijuar, OE duhet ti filloj punimete menjëherë duke evituar aksidentet fatale dhe dantimi natyrore)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                        | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 29.06.2022 (450 ditë pune).<br>Per shkak te pandemis kjo kontrate eshte e kufizuar me ndarjet buxhetore sipas Ligjit te Buxhetit. Punimet do te autorizohen vetem deri ne shumen e ndarjeve buxhetore te vitit perkates. Ne te kundërtën punimet do te vazhdojn sipas planin dinamik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Dëmet e likuiduara     | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Regjistri i punës      | 20.1 | Në vend punishte duhet te mbahet ditari dhe libri ndërtimor.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit: Bahti Nebiu, e-mail: <a href="mailto:bahti.nebiu@rks-gov.net">bahti.nebiu@rks-gov.net</a><br><br>Projket Menaxheri eshte përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të shërbimeve/punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.<br><br>Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim tek Projekt Menaxheri programin për punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Parapagimi             | 26.1 | Ministria e Infrastrukturës do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit në baze të Ligjit 07/L-001 për mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 Neni 13 nga data e caktuar nga Projekt Menaxheri kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.<br><br>Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit. |

|                                                    |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|----------------------------------------------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                    |      | Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Mbajtja e Parasë                                   | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: 10% për cdo pagesë deri në përfundimin e punimeve.<br>Parat e mbajtura paguhën me sjelljen e Garancionit bankar në vlerën prej 10 % në afat prej 24 muaj (afati i përfundimit të përiudhës së defekteve).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Përgjegjësia mbi Defektet                          | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve do të jetë 12 muaj. Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës                 | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme.<br>Nëse me fajin e OE vjen deri te shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje të palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhën mjete nga Ministria e Infrastruktura për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegitjen e punimeve që i paguan pune kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale të kontratës në Ministria e Infrastruktura dhe Transportit. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2 | Palët do të provojnë në mënyrë miqësore të zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë efekt atëherë kompetente do të jetë gjykata.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

## **ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

Për: Rikonstruimi i Rrugës Rajonale R115, Segmenti: Prizren – Prevallë Lot 1

**Lot 1: Km 0+00.00 - Km.16+00.00 L=16,000 km**

Specifikimet teknike përshkruajnë në mënyre jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të kushteve të kontratës siq janë:

Rregullat që kanë të bëjnë me projektimin, shpenzimin, testimin, inspektimin dhe pranimin e kushteve për punë, metodave të ndërtimit dhe të gjitha kushteve tjera teknike në lidhje me punët e kryera dhe të materialeve ose pjesëve të cilat ato përfshijnë.

Në këto specifikime jepen kërkesat teknike për zbatimin e kontratës për:

**Për: Rikonstruimi i Rrugës Rajonale R115, Segmenti: Prizren – Prevallë Lot 1**

Të gjitha kërkesat teknike të percaktuara në këto specifikime janë të detyrueshme për kontraktorin e punimeve.

Projektet përmbajnë të dhenat e nevojshme për zbatimin e punimeve, bazuar në matje të sakta të kryera në terren.

Për çdo mos përputhje të dhënave të projekteve me gjendjen në terren, duhet të behet azhurnimi i tyre nga zbatuesi i punimeve në konsultim me mbikqyresin e punimeve dhe nëse është e nevojshme edhe me projektuesin, dhe Punëdhënësin.

### **Hyrje**

Punimet për: **Rikonstruimi i Rrugës Rajonale R115, Segmenti: Prizren – Prevallë Lot 1**, do të referohen Standardeve dhe përshkrimeve që jepen në projektin e hartuar nga kompania: „Infra-Plus” - Prishtinë dhe “Standardeve për rrugë dhe Ura “ – viti 2004, të miratuara nga Ministria e Transportit dhe Postë – Telekomunikacionit.

Meqenëse përshkrimi i punëve me kushtet teknike janë dhënë në Projektin e hartuar nga kompania:

„Infra- Plus” - Prishtinë.

Kushteve të përshkruara në: Libri II, Përshkrimi i Punëve me Kushte Teknike, Prishtinë, Kosovë-viti 1979 dhe EUROKODEVE.

Në këto specifikime teknike do të jepet një përshkrim i shkurtër i punëve.

## 1. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Kushtet e përgjithshme të dhëna në vazhdim aplikohen për të gjitha format e Punëve të përshkruara në Specifikacionet teknike apo në dëshmitë e sasive e gjithashtu edhe në punët të cilat mund të rrjedhin dhe mund të pranohen si të domosdoshme për të kryer veprimtaritë e Punëve të pajtuara.

## 2. Përkufizimet e Termave

Termat e përdorura në Specifikacionet Teknike interpretohen si në vazhdim:

- **„Dokumentat dhe vizatimet”**- Punëryesi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë punëryesin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Punëryesi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje.
- **“Laborator”**- është organizata e cila kryen analizat dhe testimet për kontrollin e cilësisë së materialeve të përdorura gjatë ndërtimit të punëve të parashikuara në projekt.
- **“Truallthemeli”**- është pjesa e litosferës mbi të cilën është paraparë ndërtimi i trupit të rrugës apo llojit tjetër të objekteve.
- **“Humusi ( shtresa jombajtëse )”**- është shtresa e dherave e cila duhet të largohet për arsye të vetive të dobëta fizike, mekanike apo kimike.
- **“ Materiali i papërdorshëm ”**- është ajo sipërfaqe e trupit të rrugës qëndrueshmëria e të cilit është me aftësi bartëse të pamjaftueshme për ta vendosur mbi të sipërfaqën në të cilën ndërtohet konstrukcioni i mbistrukturës (sip.qarkulluese) . Materiali i papërdorshëm duhet të largohet dhe të zëvendësohet me material qëndrueshmëria e të cilit është me aftësi bartëse të mjaftueshme para fillimit të punëve tjera të konstruksionit të rrugës.
- **“Tabani i nënstrukturës”**- është truall themel i pregaditur mbi të cilën mbushja duhet të ndërtohet , dhe e cila i plotëson kushtet gjeomekanike.
- **“Tabani i mbistrukturës”**-është ajo sipërfaqe e trupit të rrugës e përpunuar e e cila i plotëson vetitë fizike dhe kimike të parapara me kushtet të veqanta teknike, mbi sipërfaqën në të cilën ndërtohet konstrukcioni i mbistrukturës .
- **“Nënstruktura e rrugës”**- është mbushja dhe nënstruktura e pregaditur.
- **“Planumi”**- është ajo sipërfaqe e pregaditur dhe e rregulluar plotësisht e cilësdo shtresë të nënstrukturës ose mbistrukturës së rrugës, të caktuara me vizatime dhe pjerrtësi të parapara me profile gjatësore dhe tërthore.
- **“Mbistruktura e rrugës”**- është pjesë e trupit të rrugës e ndërtuar mbi taban të mbistrukturës – planumin e nënstrukturës së rrugës.
- **“Filttri”**- është shtresa prej materialit i cili pengon infiltrimin e truallthemelit në mbistrukturë dhe në kanalet e drenimit ( në shpati,prapa mureve,në rigolla dhe në trup të rrugës ).

- **"Shtresë Tamponi"**- është shtresa e mbistrukturës të konstruksionit të rrugës e cila shërben si mbrojtje kundër ndikimeve të ngricave por njëherit edhe si shtresë e poshtme e mbistrukturës së konstruksionit.
- **"Konstruksioni i sip. qarkulluese"**- është pjesa njështrësore apo shumështrësore e mbistrukturës së rrugës e cila pranon ngarkesat nga trafiku dhe i përcjell ato në shtresat tjera të mbistrukturës respektivisht në mënyrë të përshtatshme në konstruksionin e objekteve.
- **"Shtresa mbajtëse"**- është secila shtresë e mbistrukturës ( konstruksionit të sip. qarkulluese ) që është ndërtuar me material të përpunuar dhe të stabilizuar me metodat mekanike apo kimike.
- **"Shtresa rrafshuese"**- është shtresa e punuar kryesisht për të arritur rrafshimin e duhur të secilës shtresë planume.
- **"Shtresa brejtëse"**- është shtresa e fundit e konstrukcionit të sip. qarkulluese.
- **"Themeli"**- është pjesa e objektit i cili drejtëpërdrejt i përcjell ngarkesat në truallthemel, të cilit i është dhënë forma dhe është dimensionuar në bazë të shenimeve detale gjeomekanike të truallthemelit, mbi të cilin vëhet themeli i objektit.
- **"Objektet në rrugë"**- janë objektet që shërbejnë për kalimin e pengesave në rrugë apo për sigurimin e konstrukcionit të rrugës, të ndërtuara mbi themele respektivisht në kushteve të përshtatshme ashtu vendos drejtëpërdrejtë në truallthemel të caktuar.
- **"Menaxher i projektit (Inxhinieri)"**- është person i autorizuar nga Punëdhënësi të menaxhojë kontratën dhe të mbikqyrë kualitetin e materialeve, cilësinë e punimeve pranoj sasi të realizuara, nënshkruaj ditarin e ndërtimit, librin ndërtimor, situatat dhe certifikatat për pagesë.
- **"Zëvendësimet"**- Zëvendësimi i materialeve të specifikuara në dokumentin e kontratës do të bëhet vetëm me aprovimin e Menaxherit të projektit (për pozicione me vlera të mëdha nga komisioni i punëdhënësit) nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të punëkryesit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të çertifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

### 3. Kontrolli i kualitetit

Plani i kualitetit duhet të tregoj se si Kontraktori do të implementoj kontrollin e kualitetit në vendpunishte në mënyrë që të garantoj Punëdhënësit se të gjitha punët do të zhvillohen sipas kërkesave të Kontratës dhe do të arrihen standardet e kualitetit.

Plani i kualitetit do të përshkruaj në mënyrë precize se si do të kryhen të gjitha fazat e punëve (paisja, metodat, organizimi i fuqisë punëtore), kush do të jetë përgjegjës për këtë (të dhënat personale të inxhinierëve) dhe si kontrolli i brendshëm do të organizohet për të garantuar kualitetin e domosdoshëm të punëve. Në veqanti, ekipi i pavarur i kontrollit duhet të kontrollojë të gjitha dokumentet e lëshuara nga Kontraktori. Verifikimi i kontrollit duhet qartë të shfaqet në dokumente.

Inxhinieri do të lejohet të vazhdoj me kontrollin e jashtëm të skemave të kualitetit, kurdo që e gjykon të domosdoshme.

Plani i kualitetit duhet të përfshijë detajet e procedurave të aprovuara, pikave të mbajtuara dhe pikave dëshmuere. Këto duhet të pajtohen me Inxhinierin (Organin Mbikqyrës).

Kontraktori do të zhvilloj Ekzaminimet paraprake, vijuese dhe kontrolluese për nevojat e tij dhe për nevojat e Punëdhënësit në laboratorët e tij apo institucionet e specializuara. Ekzaminimet kontrolluese duhet të kryhen nga Kontraktori nën mbikqyrjen dhe drejtimin e Inxhinierit. Kontraktori i mbulon të gjitha shpenzimet për të gjitha testet e specifikuara (paraprake, paralele dhe kontrollin) në kuadër të vlerave të kuotuarra të njësisë.

➤ Punëdhënësi mund të angazhoj Laborator të veçant për shqyrtime kontrolluese dhe mund në çdo kohë me kërkesën e Menaxherit të projektit (Inxhinierit) ose sipas Kushteve të përcaktuara në Kontratë, të kërkoj të bëjë shqyrtime Kontrolluese plotësuese.

➤ Ekzaminimet zhvillohen për të verifikuar:

➤ Kualitetin e materialeve të shfrytëzuar;

➤ Kualitetin e punimeve të përfunduara;

Kontraktori vë në dispozicion të Inxhinierit të gjitha rezultatet e testimeve dhe datat e këtyre testimeve në kuader të fushëpërfshirjes dhe formes së kërkuar. Kontraktori duhet ti ofroj Inxhinierit dy kopje të të gjitha rezultateve të testimeve brenda 24 orësh nga koha e kryerjes së secilit testim.

Materialet që përdoren për mbushje dhe tampon duhet të sigurohen në përputhje me kushtet e autoritetit përkatës (KPPM), duke siguruara licencat përkatëse paraprakisht.

#### **4. Lejet për Punët**

Kontraktori në shpenzimet e tij duhet të marrë lejet nga autoritetet relevante vendore. Lejet e tilla përfshijnë lejet për devijimin e komunikacionit, lejet rezidente dhe të punës, lejet për radio komunikime, lejet për vendosjen e nxjerrjes së gurëve dhe huazim të gropave, uzinave dhe strukturave sekundare të domosdoshme për përfundimin e punëve jashtë vendpunishtes.

Kontraktori duhet të arrij pajtueshmëri me kërkesat dhe duhet tu jap Autoriteve të lëshuese të lejeve mundësi të plota për të inspektuar dhe kontrolluar punët apo për të pjesëmarrë në testimet dhe procedurat kontrolluese. Kjo nuk do ta liroj Kontraktorin nga ndonjë përgjegjësi sipas Kontratës.

Asnjë veprim i rëndësishëm i ndonjë forme, në veqanti ndërprerja apo mbyllja e rrugëve ekzistuese, lidhjeve elektrike dhe të ujit apo ndonjë shërbimi tjetër komunal nuk guxon të behet pa miratimin me shkrim të Inxhinierit. Kontraktori duhet të informoj Inxhinierin në formën e shkruar me kohë dhe jo më vonë se shtatë ditë para fillimit të punëve të tilla në mënyrë që Inxhinieri të aranzhoj mbikqyrje adekuate dhe paralajmërimë për sigurinë.

#### **5. Rregullimi i trafikut**

Kontraktori është përgjegjës për rregullimin e qarkullimit të trafikut në të gjitha rrugët publike të cilat mund të jenë në funksion gjatë zhvillimit të punëve ndërtimore. Kjo pjesë paraqet kërkesat specifike të Projektit për kontroll të trafikut rrugor përmes vendpunishtes, gjë që duhet të bëhet nga Kontraktori.

Aty ku këto specifikacione janë në konflikt me ligjet e veqanta dhe/ apo legjislacionin atehere do të aplikohen ligjet dhe legjislacioni.

Kontraktori duhet të implementoj planin e Menaxhimit të trafikut në përputhje me programin e përfshirë në Plan. Në baza ditore, Kontraktori duhet të siguroj se të gjitha masat lajmëruese për ridrejtimin e trafikut dhe kërkesat e sigurisë janë implemtentuar para fillimit të ndonjë punë relevante sipas Kontratës.

Kontraktori duhet të monitoroj efektshmerinë e vazhdueshme të Planit për Menaxhimin e trafikut gjatë zhvillimit të Kontratës dhe duhet të përmirësoj dhe ripërtrijë Planin kur kjo është e domosdoshme.

Kur propozohet ndonjë ndryshim të aranzhimit ekzistuese të trafikut, Kontraktori nese urdhërohet nga Inxhinieri duhet të përgadis Planin për Menaxhimin e trafikut i cili jep qartë në detaje aranzhimet e përmirësuara të trafikut në të gjitha lokacionet që ndikohen nga ndryshimi.

Plani i përmirësuar i Menaxhimit të trafikut duhet ti dorëzohet menaxherit të projektit (Inxhinierit) për miratimin e tij së paku 7 ditë para datës së propozuar për ri-aranzhimin e trafikut.

Dështimi për tu përputhur me këto kërkesa mund të rezultoj që Inxhinieri të shtyj afatin për ri - aranzhimin e trafikut për të siguruar kohë të mjaftueshme për njohtim të publikut. Një shtyrje e tillë nuk duhet të jetë shkak për vazhdimin e kohës sipas Kontratës.

